

Reparti Ushtarak Nr.6002, Tiranë, kërkon të punësojë personel civil, të cilët të kenë kryer studimet e larta në degët: marrëdhëniet ndërkombëtare, histori, gjeografi, shkencat politike, sociologji dhe ekonomik.

Aplikimi për punësim do të bëhet në mënyrë elektronike sipas formularit bashkëlidhur dhe të dërgohet në adresën e-mail; hr6002@mod.gov.al

Afati i aplikimit nga data 04.06.2021 deri me datë 04.07.2021.

Kriteret dhe dokumentacioni.

I. Kriteret:

- 1) të jetë vetëm shtetas shqiptar;
- 2) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- 3) të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor;
- 4) të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- 5) të mos jetë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- 6) të mos jetë larguar për shkelje disiplinore nga administrata publike;
- 7) të plotësojë kushtin e sigurisë;
- 8) të mos ketë filluar ndjekja penale ndaj tij;
- 9) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të detyrës në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- 10) të mos ketë konflikt interesi me detyrën ose funksionin që do të kryejë.
- 11) të ketë qëndrim jo më pak se 5 vitet e fundit në Shqipëri, përjashtuar personin që është dërguar jashtë shtetit në përfaqësi ose mision ushtarak apo diplomatik, si dhe për studime nga Ministria e Mbrojtjes ose nga institucione të tjera shtetërore, që kanë objekt të veprimtarisë së tyre çështje të sigurisë ose të mbrojtjes.

II. Kandidatët të cilët do të përzgjidhen për procedim të mëtejshëm, do të njoftohen dhe në datën e caktuar duhet të paraqesin dokumentacionin (Hard copy) e mëposhtëm;

- 1) Kërkesë personale për punësim në Repartin Ushtarak Nr.6002;
- 2) Jetëshkrimi (Curriculum Vitae), (Nr.Tel. Fiks ose celular)
- 3) Fotokopje të diplomës së shkollës së lartë dhe diplomës së maturës shtetërore me listën e notave të noterizuara;
- 4) Fotokopje të letërnjoftimit ID e firmosur nga vetë personi;
- 5) Certifikatë familjare;
- 6) Raport mjeko-ligjor;
- 7) Vërtetim nga gjykata;
- 8) Vërtetim nga prokuroria;
- 9) Vërtetim nga Zyra e Përmbarimit;
- 10) Të kenë dëshmi të bardhë penaliteti dhe të mos kenë implikime me organet e drejtësisë;

- 11) Librezë pune (fotokopje);
- 12) Vlerësime pune (nga institucionet ku ka punuar më parë, nëse ka qenë i punësuar);
- 13) Fotokopje të certifikatave (diplomave) të kualifikimeve të kryera, trajnimeve, kurseve të ndryshme si dhe të gjuhës së huaj;
- 14) Katër fotografi me përmasa 2 (dy) cope 4x6 dhe 2 (dy) copë 9x12;
- 15) Formularin e vetëdeklarimit i cili gjendet në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën elektronike www.mod.gov.al (linku; Baza ligjore/akte ligjore/Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetëdeklarimit).

Shënim:

- Kandidatët që do të aplikojnë duhet të kenë notën mesatare të arsimit të lartë mbi 7.
- Kandidatët preferohen të kenë nivel të mirë dhe shumë të mirë të njohurive në gjuhën angleze të njohur nga institucionet shtetërore si dhe gjuhë të dyta të rralla.
- Preferohen me eksperiencë pune 3-10 vjet
- Të jenë deri në moshën 40 vjeç
- Kandidatët e përzgjedhur do t'i nënshtrohen procesit të konkurrimit (testim dhe intervistë)